

BIBLIOTEKA

E

854-1  
9/58

SHIETITI

GJIROKASTER

INDOC  
GUETJA

Rrezatim  
Poezi


819.983-1  
9.58

NDOC GJETJA

# RREZATIM

(Lirika)

~~56335~~



12504

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## **BASHKATDHETAREVE**

Në luftë apo në punë, mes njerëzve të qeshur,  
do ta mbyll një ditë kapitullin e jetës sime,  
në buzë do të lë ndonjë frazë të pashprehur,  
dhe në kokë ndonjë motiv të bukur poezie.

Dhe kur të kridhem në gjirin e tokës nënë  
i mbështjellur me pelerinën e përjetshme të  
heshtjes.

do doja që për mua bashkatdhatarët të thonë:  
— Ai na deshi me gjithë fuqinë e zemrës! . . .

## NÉ SYTÉ E MI

Afrojeni kokën te këto dritare me xhamat të  
tejdukshëm, pa perde të errta,  
të shikoni brendësinë time të ndritshme;  
ja korridori ku kam shtruar qilimat e ëndrrave dhe  
shpresave me ngjyra të ndezura;

ja salloni i hapur për dashurinë;  
ja tabela e kuqe te hyrja  
ku këm shkruar fjalët: «Mirë se vini!»,  
Mbi qilimat e ëndrrave s'lejoj të pështyjë kush  
dhe të ecë brutalisht me hap ciniku.

## INVALIDI I LUFTËS

Unë do të hyj pa trokitur në të gjitha dyert e  
shekujve  
duke mbajtur pranë zemrës teserën e kuqe,  
duke tundur përballë lumturisë suaj të gjitha plagët  
e tmerrshme  
që mora për ju, nëpër shtigje lufte.

Dy mëngët e xhaketës do më varen boshe,  
mos m'i shtrini duart se s'mund t'ua shtrëngoj, o  
nipa,  
si peng ja dhashë lirisë një ditë në llogore  
të dyja duart që kisha.

Do të hyj mes jush e do ta ngul shikimin tim zhbirues,  
të shoh nëse rron kujtimi im në zemrat tuaja,  
përndryshe do të jem më i tmerrshmi akuzues.  
për plagët që mora... për duart që humba...

## **BJONDËS GAZMORE NË SFOND TË MUREVE TË LASHTË**

Një kokë e qeshur bjonde në sfond të mureve të sertë  
e të lashtë  
m'u shfaq si imazh i bardhë i lumturisë sime të  
ardhme.

— Për një kokë të tillë u shemb Troja krejt —  
thashë —  
e ra mbi kokat e trojanëve.

M'u duk sikur erdhi nga thellësitë e kohërave tragjike  
si imazh fluid i pakapshëm, kjo vajzë e qeshur, sonte;  
për ta rrëmbyer s'do më duhet të shemb kështjella  
me mure qiklopike,  
por dobësinë e shpirtit, që quhet ndrojtje.

Për një kokë bjonde, sipas mitit, grekët hodhën në  
luftë mijëra ushtarë,

e bënë aq krime që s'do shuhen kurrë në kujtesë të  
breznive,  
kurse ty, o vetja ime, të mungon guximi t'i thuash dy  
fjalë  
bjondines gazmore që të qesh para syve...

## TOKËS

Rrudhat e mia —  
rrudhat e tua.  
Unë jam rrudhur për ty,  
ti je rrudhur për mua...

M'u desh të marr shumë plagë në trup,  
dhe ta lag me gjak tabanin tënd të fortë,  
që unë të bëhem i yti bujk,  
që ti të bëhesh e imja tokë.

## MËNGJEZ NË ALPET E VERIUT

Lisat dirigjentë. Krojet simfoni.  
Kor'i zogjve ëmbël shpërthen.  
Mbi kurrise malesh dielli kokën zgjati  
me buzëqeshje të kuqe si djalosh çapkën.

Nëpër shkallë tarracash ngjitem ngadalë  
sikur shkoj të puthem buzë për buzë me diellin.  
Në thellësi të shpirtit më përvlon një mall:  
— Sikur të kisha me vete Migjenin! ...

Mbi këtë shkëmb të rrnim një copë herë,  
duke shikuar këta tela që rendin tutje;  
do ta kënaqte ky peisazh me diell,  
blokun do ta mbushte me lirika të gëzueshme.

## **ANTIFETARE**

Me këto duar të ashpra, të forta,  
grisa ungjij e theva ikona,  
përmbysa tempuj e dogja rite  
edhe ua hodha në surrat priftrinjve.

Kur «zoti» dëgjoi kërdinë që bëra,  
më dërgoi memorandum.  
Ai më drejtohej më fjalë të ashpra:  
— I ziu, ti, kur të vih tek unë! . .

Dhe unë «zotit» i çova letër,  
e ju përgjegja me rreptësi:  
— Unë s’do vij në botën tjetër,  
në botën time unë do të rr*i*.

## MEDITIME NË VJESHTË

Unë eci mendueshëm nën neone të kërrusur  
si koka poetësh në çaste frymëzimi,  
era mbi tela me harkun e saj të padukshëm  
i bien violinës si Paganini.

Dhe unë do të desha të jem një llambë e tillë  
përjetësisht i kërrusur mbi trotuar,  
që t'i ndriçoj këta njérëz të mirë  
me dritën e mendimit tim të bardhë.

## NJË ÇIFTI

Dashuria juaj i ngjan një drame lirike pa konflikt pa perde që hapet e mbylljet pas çdo akti a tabloje; në skenën e jetës ju shoh tek ecni të qeshur e optimistë me një fëmijë të shëndetshëm për dore.

Dhe unë jam spektatori entuziazzt që duartroket artin e bukur të jetës suaj më puthje e përqafime, dhe uroj, që drama të tillë, të shfaqen mbi planet, pa gjak e intriga, pa sherre e konflikte.

## PËR TË FITUAR LIRINË E VETES

Ne kemi akoma lecka të mykura  
në brazdat e hirta të trurit,  
në folenë e kuqe të zemrës,  
Ne do t'i djegim, shokë,  
për të fituar lirinë e vetes...

## NËNËS

Unë dhe koha të kemi thinjur shumë,  
më shumë se koha të kam thinjur unë.  
Ka vite që më pret atje te vatra,  
moj e dhëmbshura, e shtrënja, e dashura...

Ti e di moj nënë, unë s'jam rrebel,  
për aventura kurrë s'më zuri mälli,  
por kur atdheu më thirri në apel  
m'u desh të gjendem në rresht i pari.

Se kish atdheu shumë plagë të pathara,  
se kish atdheu shumë rrugë të pashtuara,  
dhe mua m'u desh të mbaj mbi shpatulla  
detyra të rënda për këto dit' të gëzuara.

**PËRSE? . . .**

Sa gjëra të shëmtuara, si grindja dhe sharja,  
ndodhin shpesh mes udhës së madhe!  
Po më njerëzorja,  
më e bukura —  
puthja,  
përse të mbetet ilegale? . . .

## JETA DHE DETYRA


Jeta s'është ninullë gjumi,  
as melodi e dridhshme kitarre,  
as ëndërritje në një breg lumi  
për sytë e bukur të një vajze.

Jeta është betejë, dhe njeriu-antenë  
që kap në udhët e saj alarmet;  
vdekja është legjendë, vetëm legjendë  
që e shpikën frikacakët.

Jeta është e bukur si këngë.  
Në udhën e jetës që kur hyra,  
mbajta mbi supe bagazh të rëndë,  
mbajta mbi supe detyra.

Kurr s'kam qenë nga detyrat i lehtësuar,  
unë pa detyra s'kam bërë një hap;  
unë për detyrën rri pa gjumë,  
unë për detyrën dhe jetën jap.

Ndaj unë i ngarkuari me detyra,  
(I ngarkuar rëndë si hamall portesh)  
do desha që jetës mos m'i vijë fundi,  
pa i lënë diçka të vlefshme botës.



## DETIT

Në këtë orë të vonë,  
mbi pelerinën e dridhshme që hodhi përmbi çadra  
heshtja,

plepat shamatorë

derdhin kaosin e fjalëye të blerta.

Unë s'i kam urdhëruar këta plepa të grinden,

dhe s'jam i zoti

t'i urdhëroj këto gjethe të heshtin,

ashtu siç nuk jam i zoti

t'i urdhëroj këto qepalla të mbyllen,

duke soditur sonte detin.

Det... Det...

E kam vështirë të shkruaj një këngë të re për ty.

Gjallëria jote s'fiksohet dot

në figura statike të konsumuara

Në bregun tënd rri,

dhe ëndërroj një poezi  
me vargje të papërmbajtshëm si dallgët e tua.

Dhe vargjet që shkruaj  
rendin dallgë-dallgë,  
e përplasen bujshëm tej kufive të letrës.  
Në kufitë e letrës së bardhë  
s'përmbahet dot gjallëria e zemrës,  
dhe gjallëria jote, det.

### **PORTRËT SHQIPTARI**

Sytë me shikim të mprehtë si të shqiponjës.  
trupin të lartë e të fortë si lisi në mal.  
ecjen të sigurtë mbi kurriz të tokës,  
zemrën të zjarrtë si furrë që shkrin metal.

Po ta vendosnim këtë portret në ekspozitë  
pa një pushkë të gjatë në sup,  
kjo do t'ishte më e madhja ndër gjithë çuditë.  
do thonin njerëzit: — Ç'portret absurd!

## PARTIZANI METE

Tri të shtëna pushkësh trembën zogjtë mbi lëndinë.  
fluturat rrahën krahët mbi petale lulesh...  
Zogjtë muarën arratinë  
hapësirave të bardha, sipër fushës.

Ai ra duke spërkatur barin me tre currila gjaku,  
për herë të fundit shikoi qiellin partizani Mete,  
dielli ju duk si daullja e një kurbati,  
që do gjëmonte për lumturinë e ditëve të nesërme.

Qysh atëherë lulëzuan njëzet e shtatë pranvera,  
një lapidar i bardhë u ngrit në atë vend.  
Pranë lapidarit unë erdha me një tufë lule të freskëta,  
partizanin Mete solla ndër mend.

Puhiza pranverore sjell nga fushat e blerta  
aroma të këndshme lulesh, gjethesh;  
mbi lapidar kokën, menduar e mbështeta  
sikur e mbështeta mbi supet e Metes.

## KALIT

Në ballin tënd ku varen jelet e thinjave nga vitet  
dhe lodhja e udhëve,

vë buzët e mia  
dhe të puth, o kalë!...

E ndjej,  
s'paskam qenë poet,  
paskam qenë vargëzonjës,  
se kam lënë pa shkruar për ty ca radhë.

Në sytë e tu vështrimçiltër  
pasqyrohet natyra, njerëzit, dhe çdo gjë e gjallë që  
ndodhet në lëvizje, në ecje.

Kush thotë se përveç fjalës «hyjo!»  
Ti s'kupton asgjë nga fjalori i njerëzve?..

Unë e kam dëgjuar kushedi sa herë  
poemën lirike të hingëllimës tënde,  
ndaj me rreptësi u drejtohem karrocierëve:  
— Ndalojet rrahja me kamxhik e kuajve!

### MES GRUNAJAVE

Sa më pëlqeijnë dallgëzimet e grunjérave në arë!  
Mes tyre eci, bie në mendime,  
kallinjtë e shëndetshëm kokat kanë varë,  
sikur më nderojnë mua, bujkun e tyre.

Mes grunjérave ngrihet një shtyllë tensioni të lartë,  
poshtë puhiza dallgëzon kallinjtë;  
në këtë peisazh lulëzon èndrra e lashtë:  
«Tokë e lirë... Bukë bollëk... Dhe dritë...

## MAJAKOVSKI I REVOLTUAR

Një mbrëmje vonë zbriti ngadalë  
nga piedestali i bronxët i poemave të veta,  
udhëve të Moskës filloi të bredhë plot mall  
me ballin e rrudhur nga mendime të thella

I heshtur në një lokal vallëzimi hyri,  
tuist po kërcente komsomoli,  
një damë e pudrosur në vallëzim e thirri,  
por ai nuk luajti aspak nga stoli.

U ngrit, dhe me ironinë e tij të zakonshme thirri  
sa çiftet në ballo u trembën fort:  
— Zotërinj dhe zonja, ju lutem më tregoni,  
në Moskë jam... apo në Nju Jork?

Dhe filloi të bridhte në trotuar përsëri  
nën reflekse të dridhshme reklamash

shumëngjyrëshe,  
duke përtypur me mokrrën e zemrës së tij të  
zjarrtë  
zëmrimin si kockë të fortë, të pathyeshme.

Para tij kalojnë huliganët me rrëmuje  
dhe koketat me minifunde,  
që e përshëndesin me një theks të huaj:  
— Gut najt, mistër! End: — Hau ar ju?

Dhe ecën Majakovski duke rrrotulluar  
si prozhektorë dy sytë nervozë:  
— Kjo është çudi... Si ka mundësi?...  
Ç'duan amerikanët këtu në Moskë?...

Udhës i shkrepi në kokë një mendim i zjarrtë:  
— Do shkoj-tha-në teatrin «Ballshoj»,  
se më ka marrë malli të dëgjoj  
bubullimat e vargut tim të metaltë.

Te sporteli bleu biletë,  
në shkallët e mermerta u ngjit ngadalë,  
u ul në karrigën Nr. 15,  
diku mes njerëzve në sallë.

U hap sipari, dhe doli Jeftushenkoja  
duke deklamuar vargjet mistike,  
Majakovski u ngrit: — Palaço! — thirri,  
dhe turma e trembur ngriu në karrige.

Me vetullat e ngritura plot duf zemërimi  
si dy harqe shigjetash të ndera në ballë,  
doli duke përplasur derën rreptë  
përballë hutimit të njerëzve në sallë.

Dy polic' e ndoqën përmes sheshit,  
ai hypi në piedestal të poemave të veta,  
policët mbetën poshtë me armë në dorë,  
dhe ikën tutje si dy hije të zeza.

Në mesnatë, kur udhët heshtën,  
dëgjoi një zë që vinte poshtë nga piedestali,  
ishte një shtegëtar, i lodhur, nate,  
po i fliste një zemër proletari:

«Mirëmbrëma Majakovsk!.. Mirëmbrëma  
Majakovsk!  
Zbrit se nuk është koha të rrish atje, në piedestal,  
sot Moska ka nevojë

të zgjohet nga vargu yt metal.

Ti nuk e di Majakovsk, tani në Kremlin  
liria e shteteve po tregëtohet me çmim të ulët,  
dhe kapitali vjen firmos kambialet  
me një buzëqeshje të shkrumbët.

Ka kohë që Ylli i Kremlinit  
dritë të rrëme shpërndan mbi botë,  
sepse tani, në tryezë të Leninit  
janë mbledhë trockistët kokë më kokë.

Kur vijnë diplomatët e përtejdetit në kullë të  
Kremlinit  
me nga një degë ulliri në dorë,  
atëhere popujt ndodhen në kulm të rrezikut;  
kundër tyre patjetër diçka do të ndodhë.

Është e tmerrshme Majakovsk,  
nuk durohet dot,  
kur sheh vodkën tek përzihet me uiski  
në dollitë e «mirëkuptimit reciprok»

Erdhi koha të zbresim prapë në skenë  
me bajoneta dhe tyta pushkë  
kundra njerëzve me gusha «katërkatëshe»  
që janë ulë nëpër kolltuqe.

Ndaj, zbrit dhe ti, se nuk është koha  
të rrish atje në piedestal,  
të presin qytetet, fshatrat, stepat,  
t'i zgjosh me vargun tënd metal.

Eja poet i zemrës sonë!  
Mbi tytë të pushkës ngule vargun, si dikur,  
në fushë të betejës të shpërthejë si bombë,  
dhe të rrahë krenar porsi flamur.»

## KARL MARKSI

Bota kish miliona farmaci,  
për një dhëmbje koke njerëzit pinin ilaçe,  
bota kish miliona plagë në brinjë  
por një rryp fasho askush s'ja falte.

Nga ethet e vuajtjeve trupi i botës digjej si furrë.  
dhe dridhej nga të ftohtët edhe në ditët me diell.  
nga plagët e hapura rridhte gjaku i saj si gurre  
hapësirave të kozmosit të errta sterrë.

Por erdhi Karl Marks, dhe mbi kurriz të botës  
vuri dorën e tij eshtëmadhe,  
firmosi «Kapitalin» diagnozën e sëmundjes së kohës  
dhe filloi operacioni me shpatën proletare.

## **STOLAT NË DIMËR**

Stolat nën shiun e ftohtë dimëror  
në lulishte të qytetit po mërdhijnë,  
mbi ta bie breshër e bie borë,  
dhe era me gjuhë të akullt' i lëpin.

Dhe presin ata të strukur në heshtje dhe vetmi  
atë stinë të bukur kur do të çelin lulet,  
kur optimistja rini do të vijë  
mbrëmjeve të qeta përmbi ta të ulet.

## BARESHËS

Në qafë të vjershës kam varë  
këmborën e dashit laragan.  
Hape shtegun e gjelbëruar të shpirtit!  
Tek ti po vjen pa  
grigja e gëzueshme e fjalëve të mia.  
  
E dëgjon një këmborë që kumbon diku në  
largësi?...  
Eshtë këmbora e shpirtit tim,  
që kumbon për ty.  
Hape shtegun e gjelbëruar të shpirtit!  
Tek ti po vjen  
grigja e gëzueshme e fjalëve të mia.  
Ndjenjat e porsalindura që  
blegërijnë si qingja.

## **POETI**

Unë jam një gurgullimë frazash në prani të atyre që  
heshtin,  
një gurgullimë që përmbyt ndrojtjen e dy zemrave  
kur kanë aq shumë për të thënë.  
Jam puthja buzë pér buzë me një vajzë që sytë i  
qeshin  
duke ëndërruar të dashurin në një mbrëmje të vonë  
me hënë.  
Jam një krismë e fortë mbi kokën e atij që dremit  
në plogështi,  
jam çelës që hap ndonjë nofull të mbyllur në korin  
gazmor të jetës,  
jam postjeri i urimeve më të bukura pér çdo njeri,  
çdo njeriu i trokas tek porta e zemrës.  
Jam gjëmimi i daulles në radhët e luftërave proletare,  
jam gazmor, i zymtë, dhe herë i paqetë si dallga e  
detit,  
dhe radios sime shpesh i bie me grushtat e urrejtjes  
së madhe

kur dëgjoj krimet e agresorëve të planetit.  
Nesër, gotën e gjëzimit do ta ngrej në qiel të kohës,  
për fitoren e proletarëve do ta pij me fund  
dhe do ta trokas si këmbanë të bronxët  
në ditëvarrmin e kapitalit që u mund.

... përmendgjatë këtij si një degësoje e gjithë  
Nështë borpë e besësim që është dëgjatë që poqet  
që tifonin e protokollave që është përfunduar  
që tifonin e protokollave që është përfunduar  
**MË DUKET SIKUR MË THËRRET...**

— *Pjetër Lleshit* —

Duke lidhur linjën e këputur,  
ti lidhe  
dhe jetën tënde me pavdeksinë...  
Sa herë në kujtesën time (si në membranë të telefonit)  
zëri yt i qartë kumbon,  
më duket sikur më thërrret nga gjiri i natës së thellë:  
— Alo!  
Alo!  
A po m'dëgjon?

Po, Pjetër!  
Të dëgjoj shumë mirë,  
dhe të kuptoj se ç'ka më thua:  
«Në jetë mos dremit i qetë në diell,  
por ec tufaneve në gjurmët e mia...»

## NJE NATE

Buzëqeshja e bardhë e çarçafëve të larë  
më fton të bëj gjumë të embël;  
u shtriva të fle, por m'u kujtovë ti,  
dhe pëshpërita nën buzë ngadalë:

— Të pafsha në èndërr! . . .

Të pafsha ashtu siç dua unë,  
me kokën mendueshëm në gjoksin tim,  
dhe gjumi mos më daltë  
deri në agim!

**«AURORA»**

«Aurora» e famshme atje në muzeun e kohës  
po kalon pleqëri të zezë,  
kujton ajo bubullimat e dikurshme,  
sepse e di që s'duhet heshtë.

Me intuitë e ndjen mirëfillit:  
revizionizmi për popujt po hap një varr,  
se prapë është ngritur Pallati i dimrit  
që duhet shembë me flakë e zjarr.

Shqetësimi ja drithton trupin e metaltë,  
e padurueshme i duket heshtja,  
dhe pret ajo luftëtarët zemërzarritë  
të sulet prapë nëpër beteja.

Amep teħbiñ ēm ab komixx tħekk  
nolapsej id-ekk jaġid minn u ēm ab

Ādhaux ēm kieprax /tuu/ it ab G  
Għalli / Baritone / it ab n  
ħad il-kien / minn ēm ab u  
l-akl / it ab / minn ēm ab / it

Kur isha fēmijē, bari me gunē,  
kur ruaja grigjēn te lēndina,  
fundi i botës kujtoja unē  
eshtē prapa malit Radhima.

Në majë tē malit një ditē u ngjita,  
dhe larg, shumë larg, shikimin tħet,  
dhe i ċuditut me vete thirra:  
— Ehuu, paska male tē tħera! . . .

Nga malet zbrita e brodha shumë  
me opinga gome nē bulevardi,  
dhe pashē qē jeta qenka e bukur,  
dhe pashē se bota qenka e madhe.

Tani po iki nga qyteti,  
do għej grigjēn te lēndina,

nëpër këmbë do më hidhet qeni,  
do më presin qengjat me blegrima.

E do t'i puth qengjat me radhë,  
e do t'i çoj të pijnë në gurrë,  
e do më lutet baresha Marë  
t'i bie fyellit si dikur.

Shumë rin jasht qëndrës së mësuar  
qëndrës së mësuar qëndrës së mësuar  
qëndrës së mësuar qëndrës së mësuar

shumë rin jasht qëndrës së mësuar  
qëndrës së mësuar qëndrës së mësuar  
qëndrës së mësuar qëndrës së mësuar

shumë rin jasht qëndrës së mësuar  
qëndrës së mësuar qëndrës së mësuar  
qëndrës së mësuar qëndrës së mësuar

shumë rin jasht qëndrës së mësuar  
qëndrës së mësuar qëndrës së mësuar

## **MIGJENIT**

Migjen! Migjen!

Mos më rri në dritare të kujtesës  
ashtu i zymtë,  
i trishtë,  
melankolik!

Shih sa diell ka në dhomën time!  
Shih sa dritë ka në vjershën time!  
Në dhomën time hyrë!  
Në vjershën time zbrit!

Në hapësirën e bardhë të shpijtit tim, Migjen,  
asnje flamur melankolie nuk rreh palë-palë,  
as në çastet kur mendoj për ty,  
tani, ti, je  
poet gjashtëdhjetëvjeçar  
dhe miku im i ngushtë në poezi.

## **DESHA...**

Desha t  hyj n  zemr n t nde.  
U k rrusa,  
u k rrusa,  
u k rrusa,  
u b ra l msh sa nj  top,  
por prap, e dashur,  
zemra jote nuk m  nxuri dot.

Ndoshta dhe mund t  hyja,  
por t  them t  v rtet n,  
i k rrusur s'mund t  rrija  
atje gjith  jet n.

Zgjeroje zemr n ti!  
M  tepe !  
M  tepe !  
M  tepe !  
Dhe n  qoft  se m  nx   
do t  hyj patjet ...

## **LUFTË E BRENDSHME**

Ke qenë në kinema kur shfaqen filma për fëmijë?  
I ke parë si duartrokasin ata plot bujë,  
kur heroi me shpatë bën kërdinë  
duke vrarë ushtarët e huaj?...

Kështu dhe salla e shpirtit tim buçet,  
dhe ndjenjat brohorasin në kulm të gëzimit,  
kur mendimi proletar copton e pret  
paragrafët e kanunit të Lekë Dukagjinit.

Kjo luftë nuk zgjat si në film, dy orë,  
subjekti s'perfundon me zgjidhje artificiale,  
kanuni s'është filiz i brishtë bimor,  
por lis, me rrënje qindravjeçare.

## VETERANI I LUFTËS

Unë jam më i pamposhtur se kështjellat me mure  
qiklopike,  
më i pathyeshëm se fuqia legjendare e Anteut,  
unë kam në dorë levën që zhvendos në hapësirat  
kozmike  
drejt agimeve të ndritshme lëmshin e dheut.

Pikën e mbështetjes ma tregoi Partia ime.  
— Mbështete levën — më tha — mbi supet e forta të  
popullit!  
Dhe me të përbysa perënditë klasike  
dhe kështjellat e dhunës që mbaheshin tek altari i  
fronit të zotit.

Në njëqind beteja rashë, e prap jam gjallë;  
Unë biri i Partisë që bëra luftën,  
po që nevoja prapë vishem ushtar,  
me gjakun tim, betejat le të skuqen!


Unë zot i vetes dhe zot i tokës  
shqetësohem dhe për një fije bari,  
sepse të mos ndjesh në shpirt shqetësimet e kohës  
do të thotë të vdesësh për së gjalli.

## PASQYRA E LËNDËS

### Faqe

Bashkatzdhetarëve .....	3
Në sytë e mi .....	4
Invalidi i luftës .....	5
Bjondes gazmore në sfond të murevë të lashtë .....	6
Tokës .....	8
Mëngjez në Alpet e veriut .....	9
Antifetare .....	10
Meditime në vjeshtë .....	11
Një gifti .....	12
Për të fituar lirinë e vetes .....	13
Nënës .....	14
Përse? .....	15
Jeta dhe detyra .....	16
Detit .....	18
Portret shqiptari .....	20
Partizani Mete .....	21
Ktheu! .....	22
Nipave tanë .....	23
Kalit .....	24
Mes grunajave .....	25
Majakovski i revoltuar .....	26
Karl Marksii .....	31
Stolat në dimër .....	32
Bareshës .....	33
Poeti .....	34
Më duket sikur më thërrret .....	36
Një natë .....	37
«Aurora» .....	38
Baritore .....	39
Migjenit .....	41
Deshë .....	42
Luftë e brendshme .....	43
Veterani i luftës .....	44

56333



Tirazhi 1500 kopje      Format 70x100/32      Stazh: 2204-65

Shtypur në NISH Shtypshkronjave «Mihal Duri»,

Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1971